



**MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENICA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA
Drejtoria Teknike**

Nr. ____ Prot

Tiranë, më ____ 2019

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Për: **“W. CENTER” SHPK**

Adresa: Rr. Dritan Hoxha 1023, Tiranë

“EURO MEGA 2010” SHPK

Adresa: Rruga e Kavajës, Tregu Ushqimor, Tiranë

“AN&RA” SHPK

Adresa: Rruga Asim Vokshi, Godina 165, Hyrja 1, Kati 2, Tiranë

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur”

Numri i referencës së procedurës: REF-12834-03-07-2019.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Loti I** “Blerje detergjent, dizifektant dhe aromatizues”, Procedurë e hapur, Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat të marrëveshjes kuadër 24 muaj dhe me fond të përgjithshëm **103,263,609** (njëqind e tre milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e nëntë) lekë pa TVSH, me shumatore të çmimeve për njësi 28,067.99 (njëzet e tetë mijë e gjashtëdhjetë e shtatë pikë nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër:

2 (dy) vite nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

Publikime të mëparshme (*jo*): Buletini i Njoftimeve Publike data 11.03.2019, Nr. 10.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1) **BOE “ANBIM” SHPK + “BOJRA NEON” SHPK** **L81618008J**
+L52424016A
Emri i plotë i shoqërisë ***numri i NIPT-it***
Vlera (shumatorja e çmimeve për njësi): **7,270** (shtatë mijë e dy qind e shtatëdhjetë) lekë (pa TVSH) (*me numra dhe fjalë*)
- 2) **“AN&RA” SHPK** **K12205001I**
Emri i plotë i shoqërisë ***numri i NIPT-it***
Vlera (shumatorja e çmimeve për njësi): **17,169** (shtatëmbëdhjetë mijë e një qind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë (pa TVSH) (*me numra dhe fjalë*)
- 3) **“ATLANTIK 3” SHPK** **K22218003V**
Emri i plotë i shoqërisë ***numri i NIPT-it***
Vlera (shumatorja e çmimeve për njësi): **11,085** (njëmbëdhjetë mijë e tetëdhjetë e pesë) lekë (pa TVSH) (*me numra dhe fjalë*)
- 4) **“DIMEX” SHPK** **J61805519O**
Emri i plotë i shoqërisë ***numri i NIPT-it***
Vlera (shumatorja e çmimeve për njësi): **27,466** (njëzet e shtatë mijë e katër qind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë (pa TVSH) (*me numra dhe fjalë*)
- 5) **“EURO MEGA 2010” SHPK** **K91624505A**
Emri i plotë i shoqërisë ***numri i NIPT-it***
Vlera (shumatorja e çmimeve për njësi): **16,955** (gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntë qind e pesëdhjetë e pesë) lekë (pa TVSH) (*me numra dhe fjalë*)
- 6) **BOE “MURATI D” SHPK + “ANHEL” SHPK** **K42003004T +**
K32927202A
Emri i plotë i shoqërisë ***numri i NIPT-it***
Vlera (shumatorja e çmimeve për njësi): **17,495** (shtatëmbëdhjetë mijë e katër qind e nëntëdhjetë e pesë) lekë (pa TVSH) (*me numra dhe fjalë*)
- 7) **“SHPIRAGU” SHPK** **J81503005U**
Emri i plotë i shoqërisë ***numri i NIPT-it***
Vlera (shumatorja e çmimeve për njësi): **9,509** (nëntë mijë e pesëqind e nëntë) lekë (pa TVSH) (*me numra dhe fjalë*)
- 8) **“Ë.CENTER” SHPK** **K63029402A**
Emri i plotë i shoqërisë ***numri i NIPT-it***
Vlera (shumatorja e çmimeve për njësi): **15,309** (pesëmbëdhjetë mijë e treqind e nëntë) lekë (pa

TVSH) (me numra dhe fjalë).

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1) Arsyet e s'kualifikimit të BOE "ANBIM" SHPK + "BOJRA NEON" SHPK

- *Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 1 të seksionit 2.3 "Kapaciteti teknik" të shtojcën 9 të DT-së, pasi nuk arriti të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % e vlerës së fondit limit të Lotit I. Faturat e paraqitura nga anëtarët i Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë "Bojra neon" SHPK nuk vërtetojnë realizimin e furnizimeve të ngjashme, pasi furnizimet e realizuara nëpërmjet këtyre faturave nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit.*

2) Arsyet e s'kualifikimit të "ATLANTIK 3" SHPK

- *Ofertuesi nuk arriti të paraqesë dokumentacion provues për elementet e veçanta të ofertës ekonomike anomalisht të ulët sipas nenit 56 të LPP-së, e konkretisht në shkresën "Argumentim mbi ofertën anomalisht të ulët" të datës 26.04.2019 rezulton se mungon dokumentacioni sqarues për çmimet e 3 artikujve me numër rendor 30, 31 dhe 41, sipas formularit të ofertës ekonomike ose për 11.9% të vlerës së shumatores së çmimeve për njësi të ofertuar.*
- *Në dokumentacionin e paraqitur bashkëngjitur shkresës "Argumentim mbi ofertën anomalisht të ulët", ofertuesi nuk ka arritur të argumentojë elementet e veçanta të ofertës për artikujt e tjerë pasi, prokura e datës 01.06.2018 e lëshuar nga një kompani tjetër e autorizon ofertuesin vetëm për regjistrimin e produkteve dhe paraqitjen e interesit të kësaj kompanie, por nuk përcaktohen se për cilët artikuj dhe për më tepër nuk argumentohen se cilat janë çmimet favorizuese të dhëna nga kjo kompani, duke iu referuar artikujve që kërkohen të prokurohen.*
- *Gjithashtu rezulton se ofertuesi "Atlantik 3" SHPK ka paraqitur edhe ofertat e marra nga 2(dy) kompani të tjera prodhuese/ tregtuese, pa data dhe afate vlefshmërie të këtyre ofertave, bashkëlidhur të cilave janë paraqitur fatura tatimore shitje vetëm për 4(katër) nga 41 artikujt e kërkuar për Lotin I. Si rrjedhim ofertuesi nuk ka arritur të japë shpjegime për anën ekonomike të procesit të prodhimit të mallrave të ofruara, zgjidhjet teknike, kushtet favorizuese të jashtëzakonshme, origjinalitetin e mallrave apo zbatueshmërinë e detyrimeve që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet në vendin ku do të prodhohen, por ka paraqitur vetëm oferta nga të tretë nëpërmjet të cilave nuk argumentohen çmimet e artikujve të ofruara.*

Përsa më sipër, edhe pas shqyrtimit të të gjithë informacionit të paraqitur nga ofertuesi nuk krijohet bindja se oferta është e rregullt në të gjitha elementët e saj në përputhje me nenin 56 të LPP-së, ofertë e cila rezulton të jetë 60.5% më e ulët se fondi limit i shumatores së çmimeve për njësi. Si rrjedhim, nuk krijohet bindja se ofertuesi mund të realizojë me sukses kontratat që do të lidhen brenda marrëveshjes kuadër, pas procesit të minikonkurseve, ku kusht kryesor është që çmimet për njësi të ofruara për çdo artikull, nuk duhet të jenë më të larta se çmimet për njësi të ofruara në procedurën e prokurimit.

3) Arsyet e s'kualifikimit të "SHPIRAGU" SHPK

- *Ofertuesi nuk arriti të paraqesë dokumentacion provues për elementet e veçanta të ofertës ekonomike anomalisht të ulët sipas nenit 56 të LPP-së, e konkretisht në shkresën “Përgjigje kërkesës për sqarim” të datës 26.04.2019 rezulton se:*
- *mungon dokumentacioni sqarues për çmimet për njësi të 13 artikujve me numër rendor 1, 2, 3, 4, 5, 6, 8, 10, 23, 27, 28, 36, 37, sipas formularit të ofertës ekonomike ose për 40% të vlerës së shumatores së çmimeve për njësi të ofertuar. Në dokumentacionin e paraqitur bashkëngjitur shkresës “Përgjigje kërkesës për sqarim”, ofertuesi nuk ka arritur të argumentojë elementet e veçanta të ofertës për 13 artikujt për të cilët ka deklaruar furnitor të pritshëm një kompani të huaj (referuar tabelës analizë kosto Loti I), sepse dokumenti i datës 24.03.2019 i lëshuar nga kjo kompani e huaj nuk është në gjuhën shqipe, as i përkthyer e noterizuar, në kundërshtim me pikën 4.6 të Njoftimit të Kontratës të dokumenteve të tenderit. Gjithashtu, rezulton se nga disa faqe të paraqitura të marrëveshjes së shpërndarjes ekskluzive të datës 12.06.2017 midis ofertuesit dhe kësaj kompanie të huaj, rezulton se kjo marrëveshje ka përfunduar me datë 12.06.2018 dhe nuk është paraqitur dokumentacion se ajo është rinovuar. Po ashtu, nuk përcaktohet se për cilët artikuj dhe për më tepër nuk argumentohet se cilat janë çmimet favorizuese të dhëna nga kjo kompani, duke iu referuar artikujve që kërkojnë të prokurohen, pasi nuk janë paraqitur as shtojcat e kësaj marrëveshje (si psh Shtojca 2 “Çmimet”).*
- *mungon dokumentacioni sqarues për çmimin për njësi të artikullit me numër rendor 34, sipas formularit të ofertës ekonomike ose për 4,1% të vlerës së shumatores së çmimeve për njësi të ofertuar. Në dokumentacionin e paraqitur bashkëngjitur shkresës “Përgjigje kërkesës për sqarim”, ofertuesi nuk ka arritur të argumentojë elementet e veçanta të ofertës për këtë artikull për të cilin ka deklaruar furnitor të pritshëm një kompani të huaj (referuar tabelës analizë kosto Loti I), sepse dokumenti i datës 25.05.2018 i lëshuar nga kjo kompani e huaj nuk është në gjuhën shqipe, as i përkthyer e noterizuar, në kundërshtim me pikën 4.6 të Njoftimit të Kontratës të dokumenteve të tenderit.*
- *Gjithashtu rezulton se janë paraqitur edhe ofertat e dhëna ofertuesit “Shpiragu” SHPK nga 6(gjashtë) kompani për 23 artikuj të tjerë, të marra gjatë muajve janar-mars 2019 dhe me afate vlefshmërie të këtyre ofertave deri në 31.12.2019, bashkëlidhur të cilave nuk janë paraqitur fatura tatimore shitje. Si rrjedhim ofertuesi nuk ka arritur të japë shpjegime për anën ekonomike të procesit të prodhimit të mallrave të ofruara, zgjidhjet teknike, kushtet favorizuese të jashtëzakonshme, origjinalitetin e mallrave apo zbatueshmërinë e detyrimeve që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet në vendin ku do të prodhohen, por ka paraqitur vetëm oferta nga të tretë nëpërmjet të cilave nuk argumentohen çmimet e artikujve të ofruara. Përsa më sipër, edhe pas shqyrtimit të të gjithë informacionit të paraqitur dhe shpjegimeve të dhëna nga ofertuesi, nuk krijohet bindja se oferta është e rregullt në të gjitha elementët e saj në përputhje me nenin 56 të LPP-së, ofertë e cila rezulton të jetë 66% më e ulët se fondi limit i shumatores së çmimeve për njësi. Si rrjedhim nuk krijohet bindja se ofertuesi mund të realizojë me sukses kontratat që do të lidhen brenda marrëveshjes kuadër, pas procesit të minikonkurseve, ku kusht kryesor është që çmimet për njësi të ofruara për çdo artikull, nuk duhet të jenë më të larta se çmimet për njësi të ofruara në procedurën e prokurimit.*

4) Arsyet e s’kualifikimit të “DIMEX” SHPK

- Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 1 të seksionit 2.2 “Kapaciteti ekonomik

dhe financiar” të shtojcës 9 të DT-së, pasi nuk arriti të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në vlerën mesatare jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit për Lotin I. Nga vërtetimi për xhiron e tre viteve të fundit, të lëshuar nga administrata tatimore me datë 05.04.2019, i paraqitur në tender nga ofertuesi, rezulton se xhiro mesatare e tre viteve të fundit është në vlerën 23.621.114 lekë nga 41.305.444 lekë minimalisht të kërkuara për këtë kriter

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

Operatori ekonomik **“W. CENTER” SHPK**, me nr. NIPT K63029402A me ofertë ekonomike (shumatorja e çmimeve për njësi), 15,309 (pesëmbëdhjetë mijë e treqind e nëntë) lekë (pa TVSH) lekë (pa TVSH), me adresë: Rr. Dritan Hoxha 1023, Tiranë.

Operatori ekonomik **“EURO MEGA 2010” SHPK**, me nr. NIPT K91624505A me ofertë ekonomike (shumatorja e çmimeve për njësi), 16,955 (gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntë qind e pesëdhjetë e pesë) lekë (pa TVSH), me adresë: Rruga e Kavajës, Tregu Ushqimor, Tiranë.

Operatori ekonomik **“AN&RA” SHPK**, me nr. NIPT K12205001I me ofertë ekonomike (shumatorja e çmimeve për njësi), 17,169 (shtatëmbëdhjetë mijë e një qind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë (pa TVSH), me adresë: Rruga Asim Vokshi, Godina 165, Hyrja 1, Kati 2, Tiranë.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqiteni pranë Ministrisë së Brendshme, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, me adresë: Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë, Tel: 042 247 865, menjëherë nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen kuadër.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 02.05.2019

Ankesa: PO

Vendimet nr. 815/1 prot., datë 14.05.2019 dhe nr. 816/1 prot., datë 14.05.2019, dërguar operatorit ekonomik **“ANBIM” SHPK** & **“NEON” SHPK**.

**TITULLARI I ORGANIT QENDROR BLERËS
DREJTOR I PËRGJITHSHËM**